VENDIM
Nr.85, datë 26.12.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË SISTEMIT TË NJËJTË TË LLOGARIVE PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9, 21 dhe 23 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 18, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 26.12.2007, pasi shqyrtoi draftin e sistemit të njëjtë të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të sistemit të njëjtë të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta